



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:241346

Datë: 15.02.2024

Numri i dokumentit: 05333757

A.C.nr.6310/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj kryetar, Faton Ademi dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtar, në çështjen juridike të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, kundër të paditurit L. M., nga fshati Sllatinë – Kërpimeh, Komuna Podujevë, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm, av. A. M., nga Prishtina, rr. “Garibaldi”, nr. 2, Prishtinë, për shkak të rimbursimit të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3149/2013 datë 09.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 07.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e të paditurit L. M., nga fshati Sllatinë – Kërpimeh, Komuna Podujevë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3149/2013 datë 09.03.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.3149/2013 datë 09.03.2021, ka vendosur: MIRATOHET e bazuar kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë dhe DETYROHET i padituri L. M., nga fshati Sllatinë – Kërpimeh, Komuna e Podujevës, që paditëses t’ia kompensoi shumën prej 923.00€, në emër të rimbursimit të dëmit material të shkaktuar në aksidentin e trafikut me dt.06.09.2008 në Podujevë, me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në bankat vendore pa destinim të caktuar me tepër se një vit dhe atë nga data e parashtrimit të padisë, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 489.00€, e krejt këto në afatin prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, e nën kërcimin të përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin e paraparë ligjorë ka paraqitur ankesë përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit që ta aprovoj si të bazuar ankesën dhe ta prishë aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj ashtu që ta refuzoj në tutësi si të pa bazuar kërkesë padinë e paditëses, apo të njëjtin ta prishë dhe lëndën ta kthej në riprocedurë dhe ri vendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur paditësja, edhe pse e njëjta me kohë është njoftuar me ankesën e të paditurit.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, ekzaminojë aktgjykimin e shkallës së parë në bazë të nenit 194 dhe nenin 195, të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore gjeti se:

-Ankesa është e të paditurit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësja Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë, me datë 03.12.2013, pranë gjykatës së shkallës së parë, ka paraqitur padi ndaj të paditurit L. M., nga fshati Sllatinë – Kërpiroh, Komuna e Podujevës, me kërkesë për rimbursim të dëmit në lartësi prej 923.00 euro si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, ka mbajtur seancën për shqyrtim kryesor dhe pas administrimit të këtyre provave ka marrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.3149/2013 datë 09.03.2021, me të cilin e ka aprovuar në tërësi kërkesë padinë e paditëses, duke vendosur më konkretisht si në dispozitiv të aktgjykimin të ankimuar.

Në arsyetim të aktgjykimin gjykata e shkallës së parë mes tjerash ka arsyetuar se: Gjykata konstaton se kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse është baza juridike e kërkesëpadisë si dhe nëse është parashkruar e drejta për rimbursim. Nga provat Raportin e Aksidentit me nr.6081/08/5, datë.06.09.2008, Gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se më datën 06.09.2008, 20:45, në fshatin Bajqinë – Komuna e Podujevës, është shkaktuar aksidenti i komunikacionit nga i cili ka pësuar lëndime trupore M. M.. Deri tek aksidenti ka ardhur si pasojë e pakujdesisë së L. M., këtu të paditurit, për shkak se i njëjti pasi që i është prishur traktori, është ndalur në rrugën Kërpiroh-Podujevë duke mos vendosur shenja apo drita sinjalizuese ose trekëndëshin e paralajmërimit, me ç ‘rast është goditur në pjesën e prapme nga automjeti VW Golf, me targa 519-KS-230, të cilin drejtonte M. M., i cili nga aksidenti pëson lëndime trupore. Po ashtu, traktori në pronësi të L. M., nuk ishte i regjistruar e as i siguruar.

Më tej ka arsyetuar se: Nga ekspertiza mjekësore e Dr. Xh. S. e datës 17.05.2010, vërtetohet se M. B. ka pësuar lëndime të lehta trupore nga aksidenti i datës 06.09.2008, konkretisht ka pësuar ndrydhje të kokës dhe bërrylit të djathtë e shoqëruar me plagë prerëse gërvishtëse të ballit dhe bërrylit, përfshirë frikën, dhembje fizike si dhe ka ndikuar që i njëjti të asitohet për kryerjen e aktiviteteve jetësore si dhe të ketë ushqim të përforcuar.

Më tej ka arsyetuar se: Nga procesverbali C.nr.118/09 i datës 28.05.2013 i nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, gjykata ka konstatuar se pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit përgatitor, me pajtimin e përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, u arrit pajtim gjyqësorë, përmes të cilit është detyruar e paditura BKS në Prishtinë që paditësit M. M. nga Bajqina – Komuna e Podujevës, t’ia paguajë e dëmshpërblimit në emër të dëmit material

dhe jo material në lartësi prej 1,300.00€, mirëpo me përgjegjësi të ndarë 50%-50%, për shkak se paditësi ka kontribuar në aksident, duke ndikuar kështu që shuma e kompensimit të kap shifrën 650.00€ si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore, për padi 78.00€, për përfaqësim në një seancë gjyqësore 120.00€, për ekspertizë 50.00€ si dhe për taksë gjyqësore 25.00€, gjithsejtë në vlerë prej 273.00€, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh.

Më tej ka arsyetuar se: Nga Urdhër Transferi nr./13, dt. 03.06.2013, gjykata vërtetoi faktin se të dëmtuarit në aksidentin e komunikacionit – M. M., i është bërë pagesa në shumën e përgjithshme prej 923.00€, për dëmin material dhe jo material të pësuar në aksidentin e dt.06.09.2008. Nga dëshmia e pagesës e datës 18.06.2013, gjykata vërtetoi se BKS-ja ka transferuar shumën e përgjithshme prej 923.00€ në xhirollogarinë e të dëmtuarit nga aksidenti, në rastin konkret M. M..

Më tej ka arsyetuar se: Nga Ekspertiza e Komunikacionit dt.19.11.2020, e punuar nga S. B., vërtetohet fakti se deri të aksidenti ka ardhur si pasojë e lëshimeve nga të dy mjeteve motorike përkatëse, përkatësisht për shkak se i padituri L. M. në cilësinë e ngasësit të traktorit, ka bërë ndalje të pa sigurte në rrugë, pa sistemin ndriçues dhe sinjalizues si dhe nuk ka vendosur trekëndëshin e sigurisë mbrapa, ndërsa lëshimet e ngasësit të veturës VW Golf M. M., konsistojnë në shpejtësi jo adekuate sipas rregullave, kushteve dhe rrethanave të krijuara në komunikacion. Andaj, eksperti përfundimisht ka konstatuar se të dy pjesëmarrësit e involvuar në aksident, i kanë dhënë kontribut të barabartë aksidentit, për çka edhe bashkërisht i bartin pasojat. Andaj, bazuar në ekspertizën e komunikacionit të cilës gjykata ia fali besimin, u vërtetua baza juridike e kërkesëpadisë gjegjeshit u vërtetua fakti se i padituri është shkaktar i barabartë i aksidentit e rrjedhimisht i dëmit, ku një vlerësim i tillë është bërë edhe në procedurën C.nr.118/09 e udhëhequr pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, ku edhe ishte arritur pajtimi gjyqësor duke marr për bazë kontributin e barabartë të pjesëmarrësve në aksident. Dëmet e shkaktuara nga përdorimi i automjeteve të pasiguruara është e rregulluar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, me Rregullin 3, i datës 25 shtator 2008 mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësive të datës 25.06.2004. Neni 4.6 Rregulla 3 mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Auto përgjegjësive, parasheh: *“Në rast të dëmit të shkaktuar si pasojë e përdorimit të automjetit, ku pronari është dashur por nuk ka kontraktuar sigurimin e detyruar të autopërgjegjësive-, zhdëmtimi paguhet deri në të njëjtën shumë dhe sipas të njëjtave kushte sikur të ekzistonte sigurimi i detyrueshëm i autopërgjegjësive”*. *“Pas pagimit të dëmshpërblimit, mund të bëhet rimbursimi i shumës së paguar në bazë të kërkesës për regres nga pronari apo shfrytëzuesi i regjistruar i automjetit i cili nuk e ka siguruar automjetin, duke llogaritur këtu edhe kamatën me shpenzime”*.

Më tej ka arsyetuar se: Mbi bazën e lartcekurave paditësja ka parashtruar padi ndaj paditësit, me kërkesë për rimbursimin e shumës prej 923.00€, për dëmin tani të mbuluar në procedurë jashtë gjyqësore ndaj të dëmtuarit M. M. nga Podujeva, në aksidentin e komunikacionit të shkaktuar nga i padituri L. M., i cili në momentin e shkaktimit të dëmit ka pasur të pasiguar automjetin me të cilin ka shkaktuar aksidentin. Gjykata mbi bazën e të lartcekurave, aprovoi kërkesëpadinë e paditëses, duke aprovuar shumën prej 923.00€, në emër të dëmit material dhe jo material, pasi qe e njëjta u provua se është përmbushur në tërësi nga ana e paditëses ndaj të dëmtuarit M. M..

Më tej ka theksuar se: Gjykata i vlerësoi si të pa bazuara pretendimet për parashkrim të palës së paditur që rrjedhë nga neni 362 paragrafi 6 i LMD-së, për faktin se në rastin konkret, kërkesa e palës paditëse ndaj palës së paditur rrjedhë nga data e pagesës së shumës së lartcekur në emër të kompensimit material dhe jo material ndaj palës së dëmtuar M. M., që është data 18.06.2013, ndërsa padia është parashtruar me datë 03.12.2013.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në kuptim të nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes pajtohet me pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë pasi që përfundimi i saj është i rregullt dhe i ligjshëm për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por as me shkelje të cilat pretendohen me ankesë.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pabazuara pretendimet ankimore të paditurit se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me të meta thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore ngase Aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Gjykata në arsyetim të aktgjykimit ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare duke vërtetuar se i padituri e ka shkaktuar dëmin me fajin e tij dhe paditësja e ka kompensuar këtë dëm sipas rregullave për kompensimin e dëmit për automjetet e pa siguruar sipas sigurimit nga auto-përgjegjësia.

Gjithashtu, Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pa bazuara pretendimet ankimore të paditurit për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara e ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike. Baza juridike e kërkesëpadisë së paditëses është vërtetuar me provat materiale të bashkangjitur në lëndë, e nga të vilet është vërtetuar se deri të aksidenti ka ardhur si pasojë e lëshimeve nga të dy mjeteve motorike përkatëse, përkatësisht për shkak se i padituri L. M. në cilësinë e ngasësit të traktorit, ka bërë ndalje të pa sigurt në rrugë, pa sistemin ndriçues dhe sinjalizues si dhe nuk ka vendosur trekëndëshin e sigurisë mbrapa, ndërsa lëshimet e ngasësit të veturës VW Golf M. M., konsistojnë në shpejtësi jo adekuate sipas rregullave, kushteve dhe rrethanave të krijuara në komunikacion, fakte ky i vërtetuar nga ekspertiza e Komunikacionit dt.19.11.2020, e punuar nga S. B.. Gjithashtu është vërtetuar se në këtë aksidente është shkaktuar dëm material dhe jo material të cilin dëm paditësja e kishte kompensuar sipas pajtimit gjyqësor të arritur në procesverbalin me nr. C.nr.118/09 i datës 28.05.2013 i nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, nga i cili vërtetohet se për shkak të përgjegjësisë 50% me 50%, dëmi që duhet të obligohet i padituri është shuma prej 923.00 euro, të cilën shumë paditësja e ka kompensuar sipas urdhër transferit bankar të datës 18.06.2013. andaj, në këtë kuptim i padituri mbanë përgjegjësin që konform përgjegjësisë së tije në aksidentin e trafikut të cekur si më lartë, të kompensoj dëmin në shumë prej 923.00 euro.

Të pa bazuara janë pretendimet ankimore të paditurit, për zbatim të gabuar të drejtës materiale pasi që sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë, mbi bazë të gjendjes faktike të konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë drejtë është zbatuar e drejta materiale. Për faktin se me dispozitën e nenit 154 është paraparë se “kush tjetrit i shkakton dëm e ka për detyrë të ia shpërblej dëmin vetëm nëse provon se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”. Po ashtu e paditura ka të drejtën e rimbursimit të dëmit të paguar për automjetet të cilat nuk kanë pasur sigurim të detyrueshëm nga auto përgjegjësia sikurse në rastin konkret sipas nenit 4.6 Rregulla 3 mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësive, parasheh: *“Në rast të dëmit të shkaktuar si pasojë e përdorimit të automjetit, ku pronari është dashur por nuk ka kontraktuar sigurimin e detyruar të autopërgjegjësive-, zhdëmtimi paguhet deri në të njëjtën shumë dhe sipas të njëjtave kushte sikur të ekzistonte sigurimi i detyrueshëm i autopërgjegjësive”* ndërsa më tej parasheh që *“Pas pagimit të dëmshpërblimit, mund të bëhet rimbursimi i shumës së paguar në bazë të kërkesës për regres nga pronari apo shfrytëzuesi i regjistruar i automjetit i cili nuk e ka siguruar automjetin, duke llogaritur këtu edhe kamatën me shpenzime”*. Në rastin konkret i padituri është përgjegjës për kompensimin e dëmit të përcaktuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit i vlerësoj edhe pretendimet tjera ankimore të të paditurit të parashtruar në ankesë, por të njëjtat nuk i mori për bazë, pasi që nuk kishin ndikim në vendosjen ndryshe në ankesën e të paditurit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është konform nenit 452.1 të LPK-së, pasi që shpenzimet e aprovuara janë shpenzime të domosdoshme për zhvillimin e procedurës kontestimore.

Nga të cekurat më lartë, e duke u mbështetur në nenin 194, 195 parag.1 pika d), 200 të LPK-së, Gjykata e Apelit ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË
AC.nr.6310/2021 datë 07.02.2024

Kryetari i kolegjit, Gjyqtari
Besnik Bislimaj, d.v